

VENDIM
Nr. 1455, datë 29.10.2025

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, ZNJ. BRISEIDA KRENAR ÇAKËRRI, KANDIDAT I LISTËS SHUMEMËRORE TË “PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”, QARKU VLORË, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 2, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2994/1 prot., datë 27.10.2025, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes së deputetit znj. Brunilda Flamur Mersini, e zgjedhur në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

“Partia Socialiste e Shqipërisë” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 154, datë 24.2.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 34, datë 28.8.2025, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara më datë 11.5.2025.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 1339, datë 27.6.2025, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste të Shqipërisë, për zonën zgjedhore Qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 Maj 2025, ka fituar 9 (nëntë) mandate.

Rezulton se lista shumëmemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit 1339, datë 27.6.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 01 (një) në listën me parapëlqim, znj. Briseida Krenar Çakërri.

Me shkresën nr. 6773 prot., datë 27.10.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, znj. Briseida Krenar Çakërri, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave, në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, znj. Briseida Krenar Çakërri, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për znj. Briseida Krenar Çakërri, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, znj. Briseida Krenar Çakërri.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, znj. Briseida Krenar Çakërri, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, znj. Briseida Krenar Çakërri, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit znj. Brunilda Flamur Mersini i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, i renditur me numër rendor 01 (një) në listën me parapëlqim, znj. Briseida Krenar Çakërri.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 2, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, në zonën zgjedhore, Qarku Vlorë, znj. Briseida Krenar Çakërri.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi